



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:261172  
Datë: 27.06.2024  
Numri i dokumentit: 05865308

PML.nr.388/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, në çështjen penale ndaj të pandehurve: B. A., Sh. A. e A. A. nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe M. K. nga fshati ..., Komuna e H. të E., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale: Blerja pranimit dhe fshehja e sendeve të përfituara me vepër penale nga neni 333 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së; Falsifikimi i parasë nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 dhe veprës penale Shpërlarja e parave nga neni 302 i KPRK-së, lidhur me nenin 56 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të LPPLFT, duke vendosur lidhur me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të pandehurve: B. A., avokati Granit Hadërgjonaj, Sh. A., avokate Lumnije Zhitija, A. A. avokati Fitim Malokaj dhe M. K., avokati Sheremet Fejza, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special PPPS.nr.56/2023 të datës 26.04.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti Special, PN.1.S.nr.86/24 të datës 10.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohen si të pa bazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve: B. A., Sh.A., A. A. dhe M. K., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti Special PPPS.nr.56/2023 të datës 26.04.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti Special, PN.1.S.nr.86/24 të datës 10.05.2024.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, me aktvendimin PPS.nr.56/2023 të datës 26.04.2024 të pandehurve: B. A., Sh. A., A. A. dhe M. K., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale: Blerja pranimit dhe fshehja e sendeve të përfituara me vepër penale nga neni 333 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, Falsifikimi i parasë nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 dhe veprës penale Shpërlarja e parave nga neni 302 i KPRK-së, lidhur me nenin 56 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të LPPLFT, iu ka vazhduar masën e paraburgimit për 2 (dy) muaj, e cila masë u është llogaritur prej datës 28.04.2024 deri më 28.06.2024. Masa e paraburgimit të pandehurve u është vazhduar në bazë të nenit 184, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2, pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale KPPRK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin PN.S.nr.86/2024 të datës 10.05.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve, B. A., Sh. A., A. A. dhe M. K., ndërsa aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

-Mbrojtësi i të pandehurit B. A., avokati Granit Hadërgjonaj nga P., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurës penale nga neni 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2, pikat: 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, t'i ndryshoj aktvendimet e atakuara me kërkesë, ashtu që ndaj të pandehurit B. të aplikohen një nga masat alternative më të buta nga neni 171 paragrafi pika 1.1-1.6 të KPP-së, për sigurimin e të pandehurit në procedurë.

-Mbrojtësi i të pandehurit Sh. A., avokate Lumnije Mehmeti-Zhitija nga P., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurës penale nga neni 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1,1.2, pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, t'i ndryshoj aktvendimet e atakuara me kërkesë, ashtu që ndaj të pandehurit Sh., të aplikohen një nga masat alternative më të buta nga neni 171 paragrafi pika 1.1-1.6 të KPP-së, për sigurimin e të pandehurit në procedurë.

-Mbrojtësi i të pandehurit A. A., avokati Fitim Malokaj nga P., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurës penale nga neni 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1,1.2, pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, t'i ndryshoj aktvendimet e atakuara me kërkesë, ashtu që ndaj të pandehurit A., të aplikohen një nga masat alternative më të buta nga neni 171 paragrafi pika 1.1-1.6 të KPP-së, për sigurimin e të pandehurit në procedurë.

-Mbrojtësi i të pandehurit M. K., avokati Sheremet Fejza nga P., për shkak të drejtës për liri dhe siguri, të garantuara nga neni 29.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shkeljes së neneve 3,4,5,7,8,9,10,12,23,161,164, paragrafi 12, 273 paragrafi 2,3,5,6, 183,185,187,189,384 paragrafi 2, 432 paragrafi 1 dhe 433 paragrafi të KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e

Kosovës , t`a aprovoj kërkesën si të bazuar, ndërsa aktvendimet e atakuara me kërkesë t`i ndryshoj, ashtu që të pandehurin t`a liroj menjëherë për t`u mbrojtur në liri apo çështjen t`a kthej në rivendosje.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.163/24 të datës 20.06.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurve të refuzohen si të pa pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, përgjegjës në kërkesa dhe gjeti se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk janë të bazuara.

Mbrojtësit e të pandehurve: B. A., Sh.A., dhe A. A., në kërkesa të veçanta për secilin të pandehur, nga mbrojtës të ndryshëm por me përmbajtje po thuhet se identike të kërkesë theksojnë se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 184 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2 pikat: 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së, duke u vazhduar të pandehurve paraburgimin edhe për dy muaj, duke marrë parasysh rrethanat të cilat janë irelevante për caktimin-vazhdimin e kësaj mase, duke mos arsyetuar fare se mbrojtja në liri qenka e pamjaftueshme për sigurimin e të pandehurve në procedurë, apo zëvendësimi me ndonjë masë tjetër nga neni 171 i KPP-së, siç është masa e paraqitjes në stacionin policor apo masa e arrestit shtëpiak. Arsyetimi i gjykatave të instancave më të ulta përkitazi me vazhdimin e paraburgimit nga bazën ligjore e rrezikut të ikjes-arratisjes duke u thirrë vetëm në peshën e veprës penale, janë të pa qëndrueshme për faktin se të pandehurit në fjalë janë të gatshëm që secili t`i dorëzojnë dokumentacionet personale që dëshmojnë shtetësinë e Maqedonisë së Veriut, për të siguruar se janë të gatshëm sa herë që të jetë e nevojshme të paraqiten para organeve të drejtësisë dhe për të sqaruar çdo detal pse janë të përfshirë në këtë rast. Se paraburgimi u është vazhduar tre vëllezërve Ajrulloviski, ku secili ka familje, dhe gjenden në kushte të këqija ekonomike dhe se janë pa përkujdesje të familjeve të tyre, rrethana këto për të cilat gjykata nuk ka dhënë arsye se pse me masat tjera alternative më të buta nuk mund të sigurohet prania e të pandehurve në procedurë.

Mbrojtësi i të pandehurit M. K., në kërkesën e tij pretendon se aktvendimet e atakuara me kërkesë janë të kundërligjshme nga shkaqet, ngase dispozitivi i aktvendimeve, ashtu edhe arsyetimi i tyre janë të pa qarta, janë në kundërshtim me provat të cilat gjenden në dosje të lëndës, ashtu që vendimet i bëjnë të pa kuptueshme dhe të pa kqarta.

Mbrojtja tutje thekson se sa i përket vazhdimin të paraburgimit nga baza e dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, nuk qëndron për faktin se me asnjë fakt bindës nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprat penale për të cilat janë duke u zhvilluar hetimet, andaj një veprim i tillë i bazuar në supozime cenon rëndë të drejtat e të mbrojturit të tij dhe krijon një pasiguri të madhe juridike pasi që prokuroria në kërkesën e saj veprimet individuale i ka përgjithësuar dhe ka plotësuar figurën e veprës penale për gjithë të

pandehurit. Përderisa PSRK, nuk fakton dyshimin e bazuar mirë se për të mbrojturin e tij ekzistojnë fakte dhe prova konkrete që i argumentojnë veprimet inkriminuese të tij, e që do të mbështesin bazat dhe kushtet ligjore me të cilat do të bazohet vazhdimi i masë së paraburgimit si e vetmja masë që garantonte zhvillimin e pa cenueshëm të procedurës penale, në këtë rast aplikohet parimi in dubio pro reo që sot na paraqitet si një antitezë e aktgjykimit *abulution ab instancia*, e cila ekzistonte në procedurën penale të sistemit inkuizitor.

Mbrojtja, po ashtu sa i përket vazhdimin të paraburgimit nga baza e përgjithshme ligjore të nenit 184 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, pika 1.2.2 të KPP-së, me konstatim të gjykatave se ka rrezik të ndërhyrjes në dëshmitar apo shkatërrimin e provave, parashtrohet se sipas praktikës së GJEDNJ, një rrezik i tillë nuk mund të prezumohet në mënyrë abstrakte por duhet provohet përmes provave konkrete, gjykatat e instancave më të ulta, nuk parashtrojnë asnjë fakt, apo provë të vetme se i mbrojturi i tij ka ndërmarrë ndonjë veprim konkret në drejtim të ndikimit në dëshmitar, identiteti i të cilëve madje mbahet i fshehur nga prokuroria. I mbrojturi i tij nuk mund të shkatërroj provat materiale që gjenden në posedim të Policisë së Kosovës apo Prokurorisë sepse i mbrojturi i tij nuk ka akses në gjykatë, prokurori apo AKF. E po ashtu nuk qëndron as konstatimi i gjykatave se tre nga të pandehurit janë nga Maqedonia e Veriut dhe se mund të ndikohet nga njëri në tjetrin në ndryshimin e provave, ky është vetëm supozim i pa bazuar pasi që i mbrojturi i tij nuk ka e as që ka pasur ndonjëherë të vetme çfarëdo kontakti me të njëjtit.

Gjithashtu, mbrojtja edhe sa i përket vazhdimin të paraburgimit sipas bazës ligjore cekur si më lartë, pika 1.2.3 të KPP-së, thekson se konstatimet e gjykatave në vendimet e atakuara. se me gjetjen e të pandehurit M., në liri ekziston rreziku i përsëritjes së veprës penale, nuk qëndron pasi që i mbrojturi i tij nuk ka të kaluar kriminale, asnjëherë nuk është ndeshur me ligjin, e as mundësia që parat e konfiskuara të futen në treg, kjo për arsye se paratë janë konfiskuar dhe se të njëjtat janë në mbajtje dhe ruajtje nga Policia e Kosovës deri në asgjësimin e tyre.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme në kërkesë janë të pabazuara, ngase si gjykata e shkallës së parë po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë dhënë arsye të mjaftueshme për bazat ligjore të vazhdimin të paraburgimit. Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton dyshimi i bazuar se të pandehurit janë kryerës të veprave penale për të cilën edhe janë duke u zhvilluar hetimet, me çka është plotësuar kushti ligjore nga neni 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të KPP, për vazhdimin e paraburgimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se ka bazë ligjore edhe sipas nenit 184 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.1 e KPP-së, për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurve B. A., Sherif A., A. A. dhe M. K., nga se procedura gjendet ende në fazën e hetimeve, ashtu që nëse të pandehurit gjenden në liri ekziston rreziku i ikjes apo arratisjes për të shmangur përgjegjësisë penale për çka deri më tani janë ndaluar shtatë persona të dyshuar të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në kryerjen e këtyre veprave penale, por që në realitet dyshohet se para këtij rasti qëndrojnë edhe të dyshuarit tjerë, si dhe faktin se hetimi është zgjeruar në këtë çështje penale. Përpos faktit se disa nga të pandehurit janë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e po

ashtu edhe të pandehurit të cilët janë shtetas të Republikës së Kosovës, ka rrezik real se të pandehurit në fjalë mund të ikin e t'i shmangen ndjekjes penale pasi që kem të bëjmë me një veprë të një rreziku të lartë e sidomos kur kihet parasysh që hetimi është në fazën fillestare të tij.

Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ende ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurve në fjalë konform nenit 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2, pika 1.2.2 të KPP, ngase me gjetjen e të pandehurve në liri ekziston rreziku për të besuar se të njëjtit do të pengojnë rrjedhën e suksesshme të procedurë penale, duke ndikuar tek njëri tjetri dhe në provat, pasi që hetimet janë ende në vazhdimësi. Po ashtu duke pasur parasysh edhe faktin se tre nga të pandehurit janë shtetas të Maqedonisë së Veriut, janë vëllezër dhe kanë një vendbanim të përbashkët, lënja e të njëjtëve në liri ekziston rreziku që realisht do të ndikonin tek njëri tjetri për t'i koordinuar deklaratimet e tyre gjatë procedurës penale.

Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurve edhe më tutje sipas nenit 184, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, pika 1.2.3 të KPP, duke pasur parasysh peshën e veprave penale, mënyrat dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale, e veçanërisht rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale si dhe pasojat e shkaktuara në qarkullimin ekonomik, tregun e parave, si dhe rrezikun që i kanoset tregut në përgjithësi në Kosovë nga vënia në qarkullim e parave të falsifikuara po të lehen të pandehurit për t'u mbrojtur në liri, të njëjtit lehtë mund ti përsërisin veprat penale, apo të kryejnë vepra tjera penale, duke bërë shpëlarjen e parave të falsifikuara duke i vënë në qarkullim këto mjete. Rreziku do të ishte real edhe për faktin pasi që ekziston dyshimi i bazuar se të njëjtit janë marrë me këtë veprimtari kriminale dhe se lënia në liri e tyre do t'ua mundësonte të njëjtëve të kryejnë vepra të njëjta penale, apo të ngjashme, apo këto që i kanë filluar (shpërndarjen e parasë) t'i përfundojnë.

Nga arsyet e mësipërme, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje tjera që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin e bazave ligjore për vazhdimin e paraburgimit dhe të pretendimeve dhe kanë dhënë arsyetimin e duhur ku në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i konsideron edhe kjo Gjykatë, ndërsa lënia për t'u mbrojtur në liri apo aplikimi i masave tjera alternative të parapara nga neni 171 të KPP janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurve në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Pml.nr.388/2024 datë 21.06.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Sherif Krasniqi

Kryetar i kolegjit,  
Rasim Rasimi